



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1504 / Prot.

Tiranë më 10.10.2023

VENDIM

Nr. 41, datë 08.10 2023

“Për ndryshimin e programit të studimit në gjuhën angleze “Master i Shkencave”, në “Information Systems Engineering” në diplomë të dyfishtë/double degree me Universitetin e Camerinos, Itali dhe Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 80, Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, gërma “A”, i ndryshuar, Udhëzimin e MASR-së Nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2, i ndryshuar dhe Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat f), j) dhe cc); neni 100, si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me shkresën Nr. 581/6 Prot., datë 19.05.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 08.10.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e programit të studimit në gjuhën angleze “Master i Shkencave” në “Information Systems Engineering” në diplomë të dyfishtë/double degree me Universitetin e Camerinos, Itali dhe Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit diplomë e dyfishtë/double degree në “Master i Shkencave” në “Information Systems Engineering”.
3. Dokumentacioni përkatës të përcillet për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Dr. Artan Hoxha